

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Daimler Truck AG, me seli të regjistruar në Fasanenweg 10, 70771 Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, i dorëzuar përmes Filip Zafirovskit, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 25.03.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin Daimler Truck AG, me seli të regjistruar në Fasanenweg 10, 70771 Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, synon të fitojë kontrollin e vetëm mbi asetet e synuara të Josef Paul GmbH & Co. KG, Sperrwies 1, 94036 Passau, Gjermani, që përfshijnë: servisimin e kamionëve dhe shitjen e kamionëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 20.02.2026, e plotësuar më 02.03.2026 dhe më 11.03.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga Daimler Truck AG, me seli të regjistruar në Fasanenweg 10, 70771 Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, me të cilin Daimler Truck AG ka për qëllim të fitojë kontrollin e vetëm mbi asetet e synuara të Josef Paul GmbH & Co. KG, Sperrwies 1, 94036 Passau, Gjermani, që përfshijnë servisimin e kamionëve dhe shitjen e kamionëve, përmes shitblerjes së aseteve.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe dokumentacionit të bashkëngjitur, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira

Daimler Truck AG, është shoqëri e varur në pronësi të plotë të DTHAG (e cila është vetëm kompani holding), dhe është shoqëri aksionare e rregulluar sipas ligjeve të Gjermanisë me seli të regjistruar në Shtuttgart, Gjermani.

Daimler Truck AG është aktive në biznesin e kamionëve dhe autobusëve dhe është e fokusuar në prodhimin dhe shitjen e kamionëve dhe autobusëve. Gama e produkteve të Daimler Truck AG për kamionë përfshin kamionë të lehtë, të mesëm dhe të rëndë për transport në distanca të gjata, shpërndarje dhe transport në kantierë ndërtimi, si dhe automjete speciale që përdoren kryesisht për nevoja komunale.

DTHAG është kompani holding e grupit të kompanive Daimler Truck.

DTHAG / Daimler Truck AG nuk kontrollon asnjë shoqëri të varur në Maqedoninë e Veriut, ndërsa produktet e saj shpërndahen nga distributori i pavarur – palë e tretë e Grupit Daimler në Maqedoninë e Veriut.

Josef Paul GmbH & Co. KG, në lokacionin Passau Sperrwies në Gjermani, përfshin:

- Ofrimin e shërbimeve për kamionë (markat Mercedes-Benz dhe FUSO), autobusë (markat Mercedes-Benz dhe Setra), furgonë (përfshirë furgonë-kamper) dhe automjete të pasagjerëve (të dyja nën markën Mercedes-Benz); dhe
- Shitjen e kamionëve (markat Mercedes-Benz dhe FUSO). (së bashku: “Asetet e synuara”)

Më konkretisht, Asetet e synuara përfshijnë të gjitha Asetet materiale afatgjata, veçanërisht makineritë, instalimet mekanike, pajisjet, objektet operative, pajisjet operative dhe afariste, si dhe Asetet me vlerë të ulët.

Po ashtu përfshihen Asetet qarkulluese, veçanërisht lëndët e para, materialet ndihmëse dhe materialet operative, si dhe produktet dhe mallrat e gatshme; marrëdhëniet kontraktuale në datën e përfundimit të transaksionit; marrëdhëniet e punës; dhe evidencat afariste që i atribuohen Aseteve të synuara. Asetet që i atribuohen shitjes së furgonëve dhe shitjes së makinave të pasagjerëve (të përdorura) përjashtohen nga Asetet e synuara.

Asetet e synuara nuk përfshijnë asnjë aset në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.
Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ